



## **VENDIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

**Data e miratimit: 11 dhjetor 2020**

**Numri i lëndës: 2016-28**

**S.H.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 dhjetor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare  
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 22 shtator 2016.
2. Me shkresën e datës 23 shtatorit 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, 9 shtator 2017 dhe 17 tetor 2017, Paneli ka kërkuar nga kjo dhe nga ankuesit e tjerë që të ofronin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre.

4. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve duke ofruar informacion shtesë në lidhje me dy raste, duke përfshirë edhe këtë.
5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli iu ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shëfës së Misionit (ShM-së), EULEX-it Kosovë, duke e ftuar atë të parashtojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se me datën 26 janar 2018. Vërejtjet e ShM-së u morën më 16 tetor 2018, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
6. Më 28 mars 2019, Paneli ka shpallur lëndën të pranueshme (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-03-28%20Admissibility%20Decision%202016-28-a-fw.pdf>) në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (tani e tutje Konventa).
7. Më 11 shtator 2019, Paneli ka lëshuar vendimin e tij mbi meritat e kësaj lënde dhe gjeti se Misioni kishte shkelur të drejtat themelore të ankuesit siç ishin të mbrojtura sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2019-09-11%20Decision%20and%20Findings%202016-28%20signed.pdf>). Në atë vendim, Paneli i bëri rekomandimet e mëposhtme shëfit të Misionit:
  - i. Duke marrë parasysh rëndësinë e shkeljeve nën shqyrtim, Paneli fton shëfin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranojë shkeljen e ankueses dhe të drejtave të babait të tij të kryer nga Misioni;
  - ii. Paneli gjithashtu fton shëfin e Misionit të shqyrtojë mundësinë e shprehjes së gatishmërisë së Misionit që të vazhdoj të ndjek përpjekjet për të parë që në këtë lëndë drejtësia po vihet në vend;
  - iii. Nëse kjo nuk është bërë deri më tani, Paneli fton Misionin të sigurojë që dosja e lëndës që i përket këtij rasti të dërgohet tek autoritetet vendore kompetente;
  - iv. Paneli rekomandon që, ashtu siç ndodhi në lëndën 2017-02, Misioni duhet të konsiderojë që të ofroj rekomandime për autoritetet në lidhje me rrugët e mundshme hetimore të ardhshme që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij rasti; në këtë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni të theksojë rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe të informohen për rrjedhën e përgjithshme të hetimit;
  - v. Misioni duhet të ndërmarrë hapa aktivë për të kërkuar tek autoritetet se cilat hapa, nëse ka ndonjë, po ndërmerren për të hetuar këtë rast dhe për t'u raportuar autoriteteve kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel, nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk po përmbushin detyrimet në lidhje me këtë;
  - vi. Paneli rekomandon që ky vendim t'u ofrohet autoriteteve kompetente hetimore në Kosovë;
  - vii. Paneli gjithashtu rekomandon që shëfi i Misionit të sigurojë që aktivitetet e monitorimit të Misionit të kryhen në një mënyrë që është në përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe se siguron që kjo pjesë e mandatit të tij të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të këtyre të drejtave.



8. Paneli i kërkoi shefit të Misionit t'i përgjigjej më sipër jo më vonë se data 11 nëntor 2019. Përgjigja e Misionit u mor përfundimisht një vit më vonë, më 21 nëntor 2020.
9. Më 12 dhjetor 2019, Paneli ndryshoi Rregulloren 43 të Rregullores së tij të Punës për të autorizuar zyrtarisht Misionin (dhe jo vetëm një ankues) për të kërkuar ndonjë rishikim të gjetjeve të tij.
10. Më 20 janar 2020, Misioni përmes ushtruesit të detyrës së shefit të Misionit i shkroi Panelit, duke kërkuar rishikimin e gjetjeve të Panelit bazuar në një dokument të sapo zbuluar.
11. Me një vendim të 4 qershorit 2020, Paneli refuzoi kërkesën e Misionit për rishikim (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2020-06-04%20Decision%20on%20Request%20for%20Revision%202016-28%20signed.pdf>). Në atë vendim, Paneli ripërsëriti kërkesën e tij që Misioni duhet të konsiderojë me kujdes Rekomandimet e Panelit të 11 shtatorit 2019 dhe më tej e ftoi Misionin të informojë Panelin për hapat e ndërmarrë për të zbatuar ato rekomandime jo më vonë se dy muaj nga marrja e këtij vendimi.
12. Parashtrimet e Misionit në atë pikë u morën më 30 tetor 2020.

## II. VEPRIMET E MISIONIT NË PËRGJIGJE TË REKOMANDIMEVE TË PANELIT

13. Rekomandimi i parë i Panelit ishte:

'Duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljeve nën shqyrtim, Paneli fton shefin e Misionit që të shqyrtojë me kujdes mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranojë shkeljen e të drejtave të ankuesit dhe të babait të tij të kryera nga Misioni';

14. Për keqardhje të Panelit, shefi i Misionit nuk pranoi të miratojë Rekomandimin e Panelit. Në vend të tij, shefi i Misionit shprehu keqardhje për dështimin e Misionit për të hetuar këtë rast dhe shprehu 'keqardhjen time më të thellë ndaj ankuesit dhe anëtarëve të familjes së tij'. Një përgjigje e tillë nuk përbën një mjet të mjaftueshëm ose të përshtatshëm juridik për shkeljen e rëndë të të drejtave të ankuesit nga Misioni. Nuk ka asnjë tregues që Misioni kërkoi të kontaktojë ankuesin.
15. Lidhur me rekomandimin e dytë të Panelit ('Paneli gjithashtu fton shefin e Misionit të konsiderojë mundësinë e shprehjes së vullnetit të Misionit për të vazhduar të ndjekë përpjekjet e tij për të vënë drejtësinë për këtë rast në vend'), shefi i Misionit nënvizoi fakti që autoritetet vendore tani ishin vetëm përgjegjës për të hetuar këtë rast dhe thanë se Misioni 'nuk mund të këshillojë institucionet e Kosovës për raste individuale, as nuk mund të rekomandojë për të filluar ose rifilluar ndonjë hetim'. Për më tepër, shefi i Misionit ofroi për të monitoruar hetimin 'nëse autoritetet kompetente do ta rihapin në rastin në fjalë'. Shefi i Misionit shtoi sa vijon:

Siç u theksua më parë në lidhje me raste të tjera të ngjashme, në përputhje me mandatin e tij dhe bazuar në gjetjet e tij sistematike dhe tematike të monitorimit,

EULEX-i mund të mbështesë autoritetet kompetente duke dhënë rekomandime që adresojnë çështje strukturore dhe mund të kryejë detyra shtesë sipas kërkesës. Për shembull gjatë vitit të kaluar, EULEX-i Kosovë ka ndihmuar Njësinë e Krimeve të Luftës në Policinë e Kosovës për të krijuar një bazë të të dhënave që mundëson një sistem modern të menaxhimit të lëndëve dhe përmirësimin e kapaciteteve policore në fushat e ndërtimit të lëndëve, administrimin e lëndëve dhe analizën e rasteve të krimeve të luftës. Misioni zhvilloi një seri kursesh trajnimit për Njësinë për Hetimin e Krimeve të Luftës në Policinë e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës [...] dhe është i përkushtuar të vazhdojë ofrimin e ndihmës së mundshme brenda mundësive dhe aftësive të tij.

16. Paneli thekson që përderisa Misioni sigurisht që është i kufizuar nga natyra dhe fushëveprimi i mandatit të tij aktual (dhe burimeve shoqëruese), interpretimi i dhënë aktualisht këtij mandati nga Misioni nuk bën shumë në kontributin për rastet e personave të zhdukur (më herët nën përgjegjësi të tij) që është duke u hetuar. Të presësh që autoritetet vendore të hapin hetime për raste të tilla, nëse do të ndodhte, nuk është e mjaftueshme për të siguruar që të drejtat e atyre në fjalë, të cilat vazhdojnë të shkelen, të mbrohen në mënyrë efektive.
17. Duke marrë parasysh se Misioni dështoi për një dhjetëvjeçar në përgjegjësinë e tij për të mbrojtur të drejtat e ankuesit në këtë rast, ai i detyrohet ankuesit më shumë sesa shprehja e keqardhjes përmes parashtrimeve në Panel. Paneli është i shqetësuar se interpretimi i ngushtë i përgjegjësive monitoruese të Misionit mund ta bëjë Misionin të parëndësishme në lidhje me zgjidhjen e rasteve që dikur ishin përgjegjësi të tij.
18. Prandaj Paneli fton shefin e Misionit, edhe një herë, të konsiderojë se cilat vendime (masa) mund të merren për të siguruar që Misioni të jetë në gjendje të japë një kontribut efektiv dhe pozitiv në hetimin (përfshirë fillimin e hetimeve) të atyre rasteve.
19. Paneli gjithashtu rekomandon, nëse kjo nuk është bërë tashmë, që Misioni të sigurojë që dosja e lëndëve që i përket kësaj lënde të dërgohet tek autoritetet vendore kompetente. Shefi i Misionit konfirmoi se kjo ishte bërë në dhjetor të vitit 2018.
20. Rekomandimi i katërt i Panelit ishte:

Paneli rekomandon që, ashtu siç ka bërë në lëndën 2017-02, Misioni duhet të konsiderojë bërjen e rekomandimeve për autoritetet në lidhje me drejtimit e mundshme hetimore të ardhshme që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e kësaj lënde; në atë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni duhet të theksojë rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimit;

21. Përgjigja e shefit të Misionit në lidhje me këtë rekomandim është efektive që të thotë se Misioni mund të bëjë pak (ose asgjë) përveç nëse dhe derisa autoritetet vendore të marrin përsipër përgjegjësinë e tyre për të hetuar një rast. Kjo e vë Misionin në një pozitë që duhet të vëzhgojë shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të atyre që janë të përfshirë (përfshirë këtë ankues) ndërsa nuk është në gjendje të bëjë asgjë në lidhje me të. Një situatë e tillë është krejtësisht e pakënaqshme nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

Ai gjithashtu ngrit qartë çështjen e përputhshmërisë së mandatit aktual të Misionit me detyrimin e vazhdueshëm të Misionit për të vepruar në përputhje me standardet themelore të të drejtave të njeriut.

22. Rekomandimet e pesta të Panelit ishin shkurt si në vijim:

Misioni duhet të ndërmarrë hapa aktivë për të pyetur autoritetet se cilat hapa janë ndërmarrë, nëse ka pasur ndonjë, për të hetuar këtë rast dhe për të raportuar tek autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk janë duke përmbushur detyrimet e tyre në atë drejtim;

23. Siç u përmend më lart, shefi i Misionit në mënyrë efektive vuri në dukje mandatin aktual - të reduktuar - të Misionit për të sugjeruar që ai nuk mund të ndërmarrë një veprim të tillë nëse autoritetet vendore nuk e kërkojnë atë.

24. Paneli gjithashtu rekomandoi që vendimi i tij t'u ofrohet autoriteteve kompetente hetimore në Kosovë. Shefi i Misionit tregoi se Vendimi dhe Gjetjet e Panelit si dhe Vendimi i tij mbi Kërkesën për Rishikim ishin shpërndarë në të gjitha njësitë përkatëse të Misionit. Përveç kësaj, vendimi i mëparshëm iu komunikua gjithashtu autoriteteve vendore kompetente për të hetuar lëndën.

25. Së fundi, Paneli rekomandoi këtë:

Paneli gjithashtu rekomandon që shefi i Misionit duhet të sigurojë që aktivitetet monitoruese të Misionit të kryhen në një mënyrë në përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe që siguron që kjo pjesë e mandatit të tij të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të këtyre të drejtave;

26. Shefi i Misionit nuk e adresoi drejtpërdrejt këtë rekomandim. Prandaj, Paneli dëshiron të sjellë në vëmendjen e shefit të Misionit detyrimet ndaj të drejtave të njeriut të Misionit në lidhje me aktivitetet e tij të kaluara dhe aktuale dhe fton shefin e Misionit, edhe një herë, për të siguruar që mandati aktual i Misionit nuk interpretohet në një mënyrë të ngushtë të panevojshme që privon Misionin nga aftësia e tij për të kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, në veçanti në lidhje me të drejtat e njeriut. Paneli gjithashtu rekomandon që shqetësimet e tij, siç janë përshkruar më sipër, në lidhje me interpretimin që u jepet aktualisht përgjegjësive monitoruese të Misionit të merren parasysh siç duhet kur të kryhet ndonjë vlerësim i tillë.

27. Paneli gjithashtu i kërkoi shefit të Misionit, kur i raporton Panelit, të sqarojë se cilat kompetenca ekzekutive Misioni ende i gëzon nën mandatin aktual. Në atë drejtim, shefi i Misionit përmendi se 'nën mandatin e tij aktual Misioni mban një kapacitet ekzekutiv për të mbështetur Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës'. Nuk ka tregues të mëtëjshëm se Misioni ka 'kompetencë ekzekutive'. Nuk është e qartë për Panelin nëse ai është funksioni i vetëm 'ekzekutiv' i Misionit nën mandatin e tij aktual apo një aspekt i tij.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**GJEN** që shefi i Misionit ka zbatuar disa por jo të gjitha rekomandimet e Panelit në këtë rast;

**MË TEJ GJEN** se Misioni deri më tani ka dështuar të sigurojë mjete të përshtatshme juridike për shkeljen e të drejtave të ankuesit në këtë rast;

**PËRSËRIT** se shkelja e të drejtave të ankuesit nga Misioni ishte jashtëzakonisht serioze dhe do të sjellë pasoja të rënda për ankuesin;

**SHPREH SHQETËSIM TË THELLË** se mandati aktual i Misionit, të paktën siç interpretohet aktualisht nga Misioni, nuk është i aftë të sigurojë që Misioni të veprojë në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut dhe/ose të kontribuojë në mënyrë efektive për të siguruar mbrojtjen efektive të atyre të drejtat që ishte i detyruar të mbrojë në një përsëritje të mëparshme të mandatit të tij dhe kur detyrimet e të drejtave të njeriut vazhdojnë në lidhje me veprimet ose mosveprimet e kaluara;

**FTON** shefin e Misionit edhe një herë që të sigurojë se mandati i Misionit nuk interpretohet në një mënyrë të ngushtë të panevojshme që i privon Misionit aftësinë e tij për të kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, në veçanti në lidhje me të drejtat e njeriut;

**MBAN LËNDËN TË HAPUR** dhe **PYET** shefin e Misionit të marrë në konsideratë se çfarë hapi (hapa) mund të ndërmerr Misioni në këtë fazë dhe në bazë të mandatit të tij aktual për të siguruar një mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave të ankuesit; dhe

**KËRKON NGA SHHEFI I MISIONIT** të raportojë sa më shpejt që është e mundur për çështjen e fundit jo më vonë se me datën 28 shkurt 2021.

Për Panelin

Guénaël METTRAUX  
Kryesues

Anna BEDNAREK  
Anëtare



Anna AUTIO  
Anëtare